



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 11/39  
Datë: 08.10.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 tetor 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet politika e pronësisë për Ndërmarrjet Publike Qendrore, e paraparë sipas nenit 6, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Qeveria e Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:  
- të gjitha ministrave (ministrave)  
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës  
- Arkivit të Qeverisë

## POLITIKA E PRONËSISË PËR NDËRMARRJET PUBLIKE NË KOSOVË

### I. Synimet e pronësisë

1. Synimi i përgjithshëm i pronësisë është realizimi i vlerës maksimale të aksionarëve në NP-të qendrore përmes kërkimit të ofrimit të përfitimeve të qëndrueshme dhe pozitive brenda parametrave rregullativ të përcaktuar nga Qeveria dhe përfshirje të duhur të sektorit privat.
2. Politika e Qeverisë për pronësi ka katër synime gjithëpërfshirëse:
  - a. T'i sigurojë qeverisë një kuptim më të mirë rreth, si dhe besim në, performancën e NP-ve, përmes qeverisjes së shtuar korporative, performancës në menaxhim dhe transparencës;
  - b. Të zhvillojë struktura të duhura kapitale që i vënë disiplina financiare NP-ve duke siguruar se ato kanë kapital të mjaftueshëm për të bërë vendime për investime operative me resurse minimale të buxhetit të Kosovës;
  - c. Të sigurojë se kërkesat për kapital shqyrtohen në përputhje me nevojat afariste të NP-ve, duke e pranuar parapëlqimin e Qeverisë se investimet madhore të konsiderohen të lidhura me kërkesat e tjera për kapital në Qeveri përmes inkorporimit të kërkesave të NP-ve për ekuitet për investime domethënëse në procesin e rregullt të buxhetit.
  - d. Të përfshijë sektorin privat në operimin e NP-ve, për të arritur një pozitë ku pronësia e Qeverisë mbahet vetëm aty ku është e nevojshme për mbrojtjen e interesit publik e jo për shkak të inercisë historike.
3. Për zbatimin e politikës së pronësisë dhe arritjen e synimeve të lartpërmendura, Qeveria duhet të veprojë në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike dhe të respektojë plotësisht Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

### II. Qeverisja korporative e NP-ve.

4. Qeveria e Kosovës kërkon qeverisje korporative efikase dhe përgjegjëse të NP-ve. Kjo do të jetë në përfitim të pronarëve dhe aksionarëve të tyre dhe në përfitim të ekonomisë dhe mirëqenies së Kosovës, meqë qeverisja korporative e mirë kontribuon në zhvillimin dhe stabilitetin financiar duke fuqizuar besimin ndaj tregut, integritetin e tregut financiar dhe efikasitetin ekonomik.
5. Me ushtrimin e funksionit të pronësisë, Qeveria e Kosovës ka për qëllim t'i përcjellë rekomandimet e dhëna nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, në dokumentet e saja të fundit mbi qeverisjen korporative të organizatave afariste të inkorporuara dhe të ndërmarrjeve shtetërore, gjë që Qeveria e Kosovës pranon të jetë më e avancuara në të dyja fushat: *Parimet e qeverisjes korporative të vitit 2004* ("Parimet"), dhe *Udhëzimet për qeverisjen korporative të ndërmarrjeve shtetërore të vitit 2005* ("Udhëzimet"), që janë të bazuara në *Parimet* dhe janë plotësisht në pajtueshmëri me to.

6. Ushtrimi i funksionit të pronësisë në pajtueshmëri me Parimet dhe Udhëzimet do të jetë në dobi të Qeverisë, aksionarëve të jashtëm, si dhe ekonomisë dhe mirëqenies së Kosovës. Andaj, Qeveria e Kosovës ndihet e gatshme që të veprojë ngushtë në përputhje me Parimet dhe Udhëzimet.
7. Në prapavijë të Ligjit për ndërmarrjet publike kjo politikë e pronësisë ka për qëllim vënien e rregullave të përgjithshme, frymëzuar nga Parimet dhe Udhëzimet, në atë mënyrë që Qeveria e Kosovës do të ushtrojë funksionin e saj të pronësisë.

### **III. Përzgjedhja e bordeve të drejtorëve dhe komisioneve të auditimit.**

8. Anëtarët e bordit të drejtorëve dhe komisioneve të auditimit të NP-ve përzgjidhen vetëm në bazë të meritës, nga mesi i personave kompetent dhe të pavarur që kanë aftësi të ushtrojnë gjykim objektiv dhe të pavarur në interesin ekskluziv të NP-së.
9. Përzgjedhja e drejtorëve bëhet përmes një procesi konkurrues, të hapur dhe transparent, organizuar sipas Ligjit për ndërmarrjet publike.
10. Qeveria ka një pritshmëri që pagesa që ju është ofruar drejtorëve dhe pagesa shtesë ofruar anëtarëve të komisionit të auditimit caktohet në nivelet që mbizotërojnë në treg dhe, në çfarëdo rasti, në nivele që nuk paragjykojnë mundësinë e NP-ve për të tërhequr aftësitë dhe kompetencat e kërkuara.

### **IV. Mbikëqyrja e bordeve të drejtorëve dhe komisioneve për auditim.**

11. Qeveria e Kosovës ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze mbi sjelljet e bordeve të drejtorëve dhe komisioneve për auditim të NP-ve.
12. Mbikëqyrja e Qeverisë bazohet në parimin e llogaridhënies, që pasqyron një qasje jointervenuese, karakterizuar nga respektimi i plotë i Qeverisë ndaj pavarësisë së bordeve të NP-ve, por karakterizuar gjithashtu edhe nga ajo që secili bord të jetë në mënyrë rigoroze llogaridhënës për performancën e NP-ve.
13. Nëse performanca e ndonjë NP-je devijon nga caqet e caktuara në planin e biznesit të miratuar nga bordi i drejtorëve për vitin financiar përkatës, Qeveria e Kosovës duhet të kërkojë raport nga bordi i drejtorëve, ku do të përcaktoheshin arsyet që shpjegojnë performancën e ulët, dhe duhet të ndërmarrë ndonjë veprim rregullues të duhur.
14. Në çfarëdo rasti, nëse NP-ja nuk i përmbushë caqet e performancës së saj gjatë dy viteve financiare të njëpasnjëshme, Qeveria e Kosovës ndërmerr një hetim formal të performancës së ndonjë bordi të tillë.
15. Qeveria e Kosovës, ndihmuar nga Njësia e NP-së për politika dhe monitorim, i shqyrton procesverbalet e çdo takimi të bordeve të drejtorëve të NP-ve, si dhe dokumentet e paraqitura aty; kurdo që është e nevojshme, Qeveria e Kosovës kërkon informata më specifike dhe takohet me drejtorët e NP-ve dhe kryeshefat ekzekutiv të tyre.
16. Marrëdhëniet e Qeverisë së Kosovës me bordet e drejtorëve dhe komisionet e auditimit të NP-ve rregullisht kanalizohen përmes kryesuesve të tyre.

17. Ushtrimi i detyrës së mbikëqyrjes nga ana e Qeverisë së Kosovës nuk ndërhynë në pavarësinë e bordeve të drejtorëve dhe komisioneve të auditimit të NP-ve.

#### **V. Zbatimi i detyrave të besuara të drejtorëve**

18. Kurdo që ka informata të besueshme që sugjerojnë se bordet e drejtorëve, komisionet e auditimit ose drejtorët individual të NP-ve mund të kenë vepruar në kundërshtim me detyrat e tyre të besuara, Qeveria e Kosovës pa vonesë do të zhvillojë një hetim të hollësishëm të çështjes.

19. Nëse Qeveria e Kosovës konstaton se në të vërtetë ka ndodhur shkelje e detyrave të besuara të drejtorëve përkatës, atëherë ajo menjëherë do t'i shkarkojë dhe zëvendësojë ata, ose tërë bordin e drejtorëve, dhe menjëherë duhet të kërkojë masa ligjore kundër tyre kurdo që provat në dispozicion duken të jenë të mjaftueshme për ngritjen e padisë për kompensimin e dëmeve që i janë shkaktuar NP-së. Padia e tillë duhet të ngrihet në rast se konstatohet se shuma që mendohet të kompensohet është më e lartë sesa dëmi që i është shkaktuar kompanisë.

20. Nëse Qeveria e Kosovës është e mendimit se shkelja e detyrave të besuara të drejtorëve përkatës me siguri ka ndodhur, ajo menjëherë duhet t'i shkarkojë dhe zëvendësojë ata, apo tërë bordin e drejtorëve, edhe në mungesë të provave të qarta, pavarësisht nga rreziku që NP-ja mund të detyrohet të jua kompensojë dëmet drejtorëve të shkarkuar.

#### **VI. Auditimi.**

21. NP-të klasifikohen si sipërmarrje publike për qëllime të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi dhe Ligjit për auditimin e brendshëm dhe, vetëm kur Ligji mbi Ndërmarrjet në Pronësi Publike nuk parashihet, NP-të duhet të veprojnë në pajtueshmëri me ligjet e tjera përkatëse gjatë kryerjes së proceseve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.

#### **VII. Pasqyrat financiare dhe dividendët.**

22. Para takimit të përgjithshëm vjetor të çdo NP-je, bordi i çdo NP-je duhet t'i ketë pasqyrat financiare të audituara nga ndonjë auditor i kualifikuar në pajtueshmëri me ligjin përkatës.

23. Nëse auditori i cilëson pasqyrat financiare (si jo të vërteta, jo të drejta, jo të sakta dhe në mospajtueshmëri me ligj), kjo do të jetë shkak për Qeverinë e Kosovës që të shkarkojë dhe zëvendësojë bordin e drejtorëve, përveç nëse konstaton që rrethana apo ndodhi të pafavorshme objektivisht të paparashikueshme e kanë parandaluar bordin e drejtorëve, ose komisionin e auditimit, nga kryerja e duhur e detyrave të tyre përkatëse të mbikëqyrjes.

24. Dividendët deklarohen duke pasur parasysh pasqyrat financiare të audituara.

#### **VIII. Kapitali aksionar i NP-ve.**

25. Struktura kapitale e NP-ve duhet të jetë adekuate me nevojat e bizneseve të tyre dhe në pajtueshmëri me normat ndërkombëtare për industri. Nëse ndonjë NP ka kapital aksionar tepër të lartë, ai duhet të ulet pa vonesë përmes pagesës së një dividendi Qeverisë së Kosovës.

26. Kur kapitali i tepërt i një NP-je mbahet në bankat vendore, Qeveria duhet të ketë parasysh ndikimin e sektorit bankar në mënyrën se si i trajton dividendët e paguara nga NP-të. Konsiderimi i tillë nga ana e Qeverisë do të ndërlidhet me trajtimin fizik të mjeteve pas deklarimit të dividendëve por nuk duhet të ketë ndikim mbi kërkesën thelbësore për bordet e NP-ve për të deklaruar dividend kur NP-ja ka kapital të tepërt.
27. Kur kërkohet në mënyrë objektive, subvencionet apo kontributet e freskëta ndaj kapitalit aksionar të NP-ve mund të kërkohen nga Qeveria e Kosovës përmes procesit të rregullt të buxhetit të Qeverisë, siç parashihet në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.
28. Struktura kapitale e NP-ve qendrore duhet të shqyrtohet rregullisht.
29. Nuk duhet të ketë ndërsuvencionim mes NP-ve, në asnjë mënyrë.
30. Mbështetja nga Qeveria Qendrore për NP-të lokale është paraparë në buxhetin e tanishëm për vitet 2009-11. Kjo është në pajtueshmëri me politikën e Qeverisë Qendrore për kërkimin e përfshirjes së sektorit privat në operimin e NP-ve por reflekton se Qeveria Qendrore nuk ka kapacitet për ta imponuar këtë mbi NP-të lokale. Për NP-të lokale, çdo subvencion apo kapital aksionar i freskët, do të kërkohet të përmbushet nga burimet komunale përtej periudhës së planifikimit të buxhetit të tanishëm, duke ditur që aksionet e NP-ve në nivel komunal përtej asaj kohe do të jenë në diskrecion të komunave përkatëse.
31. Qeveria do t'ju ofrojë komunave këshillim teknik mbi përfshirjen e mundshme të sektorit privat në operimin e NP-ve lokale, përfshirë nga Njësitë e partneritetit publik privat të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

#### IX. Qëllimi korporativ i NP-ve.

32. Qëllimi korporativ i NP-ve nuk duhet të shtrihet në veprimtari të reja përveç nëse një shtrirje e tillë është objektivi i nevojshme për ruajtjen apo shtimin e vlerës së biznesit të tanishëm të NP-së për shkak të rrethanave të ndryshuara.
33. NP-të nuk autorizohen të ndërmarrin biznese të reja jashtë qëllimit të tyre korporativ të cekur, që mund të jetë shtrirë sipas paragrafit paraprak.

#### X. Përfshirja e sektorit privat.

34. Qeveria në mënyrë aktive do të kërkojë përfshirjen e sektorit privat në NP-të qendrore në rrethana kur kjo siguron përfitim publik për popullin e Kosovës, lidhur me:
  - a. Efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara nga NP-të;
  - b. Ndikimin e përgjithshëm ekonomik të modeleve të pronësisë alternative;
  - c. Kapacitetin e buxhetit për dhënie të investimeve në NP të nevojshme për ofrimin e shërbimeve të ardhshme; dhe
  - d. Natyrën e konkurrencës brenda industrisë në të cilën operon NP-ja.

35. Pavarësisht nga kjo që u cek më lartë, kur ndonjë NP qendrore (apo njësi operative e ndonjë NP) operon në një treg plotësisht konkurrues, që i nënshtrohet kontrollit rregullativ, Qeveria do të kërkojë të privatizojë NP-në (ose dhënien me koncesion)

**XI. Transparenca dhe zbulimi i informatave.**

36. Qeveria e Kosovës publikon pasqyrat vjetore financiare të çdo NP-je dhe pasqyra vjetore të konsoliduara financiare të të gjitha NP-ve.
37. Qeveria e Kosovës publikon informata mbi të gjitha veprimet e ndërmarra për zbatimin e detyrave të besuara të bordeve të drejtorëve të NP-ve dhe mbi rezultatet e veprimeve të tilla, përfshirë një përmbledhje të shkurtër të shkeljeve të supozuara, masave rregulluese të kërkuara dhe të ndonjë vendimi gjyqësor.